REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2648/ 7 prot Datë 20/10/2026

V E N D I M
Nr. 1407/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Donika Daci	Anëtar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20/10/2026 u shqyrtua ankesa me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK në procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur*", me Nr. REF-92685-07-07-2026, me objekt: "*Blerje materiale të ndryshme elektrike*", me fond limit 12,226,208 (*dymbëdhjetë milion e dyqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e tetë*) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.07.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Kamëz.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Kamëz.
Adresa: Bulevardi "Nënë Tereza", Nr. 492, Kamëz.

Ankimues: Operatori ekonomik "*2 AS Invest*" SHPK me NIPT M11803504B, Adresa: Lagjja 13, Plazh, Zona Kadastrale 8518, Nr. Pasurie 58/338+1-43, Kati 8, Durrës.

Subjekte të Interesuara: Operator ekonomik "*Olsi Motors Motors*" SHPK, me NIPT L71619028E, Adresa: Rruga "Elez Isufi", Zona Kadastrale 8320, Pasuria nr. 10/340, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*",

i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave* "*Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.07.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit *"Procedurë e Hapur*", me Nr. REF-92685-07-07-2026, me objekt: "*Blerje materiale të ndryshme elektrike*", me fond limit 12,226,208 (*dymbëdhjetë milion e dyqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e tetë*) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.07.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Kamëz.

II.2. Në datën 23.07.2026 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 05.08.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Olsi Motors” SHPK 10,479,700 lekë kualifikuar
2. “2 AS Invest” SHPK 11,805,850 lekë kualifikuar
3. “Xheri’s Company” SHPK 12,007,790 lekë kualifikuar
4. “2Z Konstruksion” SHPK 12,200,000 lekë skualifikuar
5. “Beqiri” SHPK 12,220,480 lekë skualifikuar

II.4. Në datën 05.08.2026, operatori ekonomik “*2 AS Invest*” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.5. Në datën 17.08.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.6. Në datën 24.08.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/7196 dhe nr. 2648/2026 protokolli, datë 25.08.2026 e operatorit ekonomik “*2 AS Invest*” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Olsi Motors*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit me argumentat si vijon:

Ne kriterin kualifikues te pikes 2.3.1 te siperpermendur eshte percaktuar kriteri kualifikues si ne vijim: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. ose b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Kete pretendim tonin e mbeshtesim nisur nga pervoja jone e gjate ne fushen e furnizimit te institucioneve publike me mallrat objekt prokurimi si dhe referuar Buletineve te Njoftimeve Publike te botuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, gjithashtu dhe burimit te hapur te te dhenave sic eshte dhe faqja zyrtare e opencorporates (te financuar nga Ambasada Amerikane). Nga ku na rezulton se kjo kompani nuk ka kryer furnizime te ngjashme me proceduren e mesiperme objekt ankimimi dhe konkretisht me shitjen e materialeve elektrike. Nga verifikimi qe kemi bere na rezulton se ky operator ekonomik Olsi Motors ndere vite ka fituar keto kontrata: inkun: https://openprocurement.al/sq/pcompany/list/corporate_id/J72603129H, na rezulton se ky operator ekonomik ka realizuar keto kontrata..... Nga verifikimi i te gjitha kontratave te listuara me siper apo qofte edhe atyre te paraqitura ne SPE per kete procedure prokurimi na bene te dyshojme se operatori ekonomikm Olsi Motors shpk nuk ka kontrata te ngjashme kjo

referuar dhe kerkimit tone te bere ne faqen zyrtare te opencorporates dhe konkretisht ne linkun: https://openprocurement.al/sq/pcompany/list/corporate_id/J72603129H ku na rezulton se kjo kompani nuk ka kryer asnje kontrate furnizime te ngjashme ne sektorin publik si qendror ashtu dhe vendor e kryesisht ne kryerjen e furnizimeve ne fushen e materileve elektrike, nderkohe qe nuk figuron asnje kontrate e fituar me ente publike me objektin e prokurimit pra materiale ndricimi elektrike. Por edhe nese ky operator ka dorezuar ndonje kontrate te ngjashme atehere nese do te veconi zerat e ngjashem te kontratave te dorezuara nuk arrijne vleren e kerkuar sipas kriterit kualifikues te percaktuar ne piken 2.3.1. Duke qene se ne si shoqëri kemi vite qe operojme ne kete fushe, dhe njohim konkurentet tane kemi dyshimet tona se operatori ekonomik Olsi Motors SHPK, nuk ka eksperienca te ngjashme për furnizimin e mallrave objekt prokurimi, dokumentacioni si fatura shitje dhe kontrata furnizimi i paraqitur prej tij ne kete procedure prokurimi nuk ploteson 2 nga 3 komponentet qe duhet te permbaje nje kontrate e ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Autoriteti kontraktor ne piken 2.3.1 ka parashikuar ne menyre te qarte se per kontratat e realizuara me ente publike operatoret ekonomik duhet te paraqesin ose 1- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara OSE 2- Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

Ndaj kerkojme se pari te verifikoni nese dokumentacioni i paraqitura per te vertetuar plotesimin e kriterit 2.3.1 eshte i vlefshem pra eshte paraqitur Vertetim Realizimi se bashku me Faturat, dhe per Kontratat e paraqitura eshte paraqitur dhe Vertetimi I Realzimit.

Se Dyti kerkojme qe te verifikoni kryesisht ngjashmeria e zerave te faturave dhe kontratave, si dhe afati i tyre dhe cka eshte me kryesorja nese plotesojne VLEREN prej 40% te fondit limit.

Per sa i perket pretendimit se operatori ekonomik Olsi Motors nuk ploteson piken 2.3.3 kapaciteti teknik te kritereve te veçanta të kualifikimit të Shtojcës 8 Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit: të dokumentave të tenderit.

Ne kriterin kualifikues te pikes 2.3.3 te siperpermendur eshte percaktuar kriteri kualifikues si ne vijim: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/ distributori zyrtar për artikujt 1-8 objekt të prokurimit. Në rast se do te paraqitet autorizim distributori duhet te provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Secili nga dokumentat duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: tel, fax, email, ëebsite, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij.

Ne Shtojcen 7 Formulari i Sasise dhe Grafikut te Levrimit nga ana e autoritetit kontraktor eshte percaktuar si ne vijim nder te tjera:

NR	***EMËRTIMI I MALLIT***	***NJËSIA***	***SASIA***
1	*Ndriçues LED 100Ë*	*copë*	*3284*
2	*Ndriçues LED 50Ë*	*copë*	*1600*
3	*Konektorë për kabull 2x16 mm2*	*copë*	*5868*
4	*Tirantues për kabull 2x16 mm2*	*copë*	*5868*
5	*Automat 4P 40 A*	*copë*	*100*
6	*Sensor muzgu 25 A*	*copë*	*200*
7	*Lëshues 4P 45 A*	*copë*	*100*
8	*Automat 2P 25 A*	*copë*	*100*

Nisur nga eksperienca jone ne kete fushe, si dhe referuar buletineve te APP-se kemi konstatuar se ky operator ekonomik eshte pjesemarres me teper ne procedura prokurimi Blerje e Vogel, pra duke njohur kpacitetet e ketij operatori ekonomik kemi dyshimet tona se kjo shoqeri Olsi Motors SHPK, nuk ploteson kriterin kualifkues te pikes 2.3.3 te Kritereve te Veçanta te Kualifikimit (lidhur me dorezimin e autorizimit te prodhuesit ose distributorit te autorizuar), 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/ distributori zyrtar për artikujt 1-8 objekt të prokurimit. Në rast se do te paraqitet autorizim distributori duhet te provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Secili nga dokumentat duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: tel, fax, email, ëebsite, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij . Operatori ekonomik Olsi Motors shpk nuk ka dorezuar Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i Autorizuar si dhe dokumentin qe veteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit per te artikujt me numer rendor 1-8. Nisur nga eksperienca jone ne fushen e prokurimeve publike nuk rezulton qe ky operator ekonomik te kete marre pjese ne procedura prokurimi furnizim mallrash ndricimi elektrik, e aq me teper me objektin e prokurimit, nga verifikimet tona si ne buletinin publik te njoftim fituesve por edhe ne faqen openprocurment. al, nuk na rezulton qe ky operator te jete shpallur fitues persa i perket materialeve elektrike te ndricimit, ndaj mendojme se ky OE nuk permbush kriterin 2.3.3 te kapacitetit teknik.

Konkretisht po ju sqarojme se diten dhe oren e percaktuar nga ana e AK per plotesimin e pikes 2.3.7 ate te mostrave jemi paraqitur ne presence te te gjithe operatoreve ekonomik per dorzimin e mostrave aty kemi vene re se operatori ekonomik per te cilin ne kemi pretendime ka dorezuar moster perkatesisht per artikullin nr. 1. Ndricues Led 100W ku ne ambalazhimin e saj kishte emertimin Brika Elektrik, Ne dijenin tone Brika Elektrik nuk eshte prodhues i ketij artikulli por distributor, ndaj kerkojme qe te verifikohet qe ne permbushje te kriterit 2.3.3 ky oe ka paraqitur dokumentacion te vlefshem per permbushjen e tij sepse nese ka paraqitur vertetim distributori nga kompania Brika elektrik atehere ne permbushje te kerkeses se ak do te duhej te paraqiste edhe dokumentacion qe te vertetonte lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit Brika elektrik.

Diten dhe oren e percaktuar nga ana e AK per plotesimin e pikes 2.3.7 ate te mostrave jemi paraqitur ne presence te te gjithe operatoreve ekonomik per dorzimin e mostrave aty kemi vene re se operatori ekonomik per te cilin ne kemi pretendime ka dorezuar moster perkatesisht per

artikullin nr. 2. Ndricues Led 50W ku ne ambalazhimin e saj kishte emertimin Lux Italia Profesional, Ne dijenin tone kjo shoqeri eshte nje prej prodhuesve me te medhenje ne ITALI per prodhimin e ndricuesve LED, ndaj duke ditur kapacitetin dhe xhiron e ketij operatori ekonomik kemi dyshimet tona se Olsi Motors SHPK e ka te pamundur te paraqese dokumentacion si autorizim prodhuesi ne menyre te drejtperdrejte nga kompania Lux italia profesional, ndaj kerkojme qe te verifikoni nese eshte paraqitur autorizim prodhuesi per kete produkt nga ky OE, dhe nese nuk eshte paraqitur a eshte paraqitur autorizim distributori nese eshte paraqitur kjo e fundit a ka arritur te vertetoje ky oe lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te deklaruar prej tij, ne permbushje te kriterit kualifikues ne piken 2.3.3.

Gjithashtu per plotesimin e pikes 2.3.7 diten e dorezimit te ofertave kemi konstatuar nga ambalazhimi i mostres se per artikullin nr. 6 Sensor Muzgu 25 A ka paraqitur moster nga kompania Horoz Elektrik, nga eksperienca dhe bashkpunimi yne ne kete fushe me prodhues dhe distributor te ndryshem na rezulton se kjo kompani horoz elektrik prodhues i ketij artikulli ka si distributor te autorizuar ne shqiperi kompanine Teoren shpk, ne dijenin tone kompania Teoren na ka pajisur vetem neve me autorizim distributori, per kete arsye kerkojme qe te verifikoni nese eshte paraqitur autorizim prodhuesi nga operatori ekonomik Olsi Motors SHPK cka per ne eshte e pamundur qe ky oe te kete marrveshje bashkepunimi me prodhuesin, gjithashtu nese nuk ploteson kete pike kerkojme qe te vertetohet nese ky oe ka paraqitur vertetim distributori ne plotesim te kriterit 2.3.3 a ka paraqitur ky oe dokument qe verteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit sikurse eshte kerkuar ne kriterin 2.3.3.

Gjithashtu per plotesimin e pikes 2.3.7 diten e dorezimit te ofertave kemi konstatuar nga ambalazhimi i mostres se per artikullin nr. 7 Lëshues 4P 45 A ka paraqitur moster nga kompania ABB, nga eksperienca dhe bashkpunimi yne ne kete fushe me prodhues dhe distributor te ndryshem na rezulton se kjo kompani ABB prodhues i ketij artikulli ka si distributor te autorizuar ne shqiperi kompanine Albaelectrica shpk, ne dijenin tone kompania Albaelectrica na ka pajisur vetem neve me autorizim distributori, per kete arsye kerkojme qe te verifikoni nese eshte paraqitur autorizim prodhuesi nga operatori ekonomik Olsi Motors SHPK cka per ne eshte e pamundur qe ky oe te kete marrveshje bashkepunimi me prodhuesin, gjithashtu nese nuk ploteson kete pike kerkojme qe te vertetohet nese ky oe ka paraqitur vertetim distributori ne plotesim te kriterit 2.3.3 a ka paraqitur ky oe dokument qe verteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit sikurse eshte kerkuar ne kriterin 2.3.3.

Pra ne kemi dyshimet tona se operatori ekonomik Olsi Motors shpk dukë qënë se në këtë procedure nuk mund te kete paraqitur autorizim distributori në përmbushje të kriterit të sipërcituar, ky i fundit mund te kete paraqitur Autorizim Distributori, per kete arsye kerkojme qe te verifikohet se pari nese eshte paraqitur autorzim prodhuesi dhe dsitributori si dhe te verifikohet nese eshte paraqitur doKument qe te vertetoje lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit ne perputhje me kriterin e kualifikimit. Pra me anë të autorizimit të paraqitur nga OE Olsi Motors SHPK lëshuar nga prodhuesi, në asnjë rast nuk janë dhënë kompetencat dhe tagrat e rishitjes së palëve të treat, pra vertetimet e paraqitura nga distributoret nuk ka patur të drejta rishitje, ndaj dhe autorizimi i leshuar per Olsi Motors shpk eshte nul i pavlefshem. Ndaj gjykojme se operatori ekonomik Olsi Motors shpk ka paraqitur dokumentacion i cili nuk

është në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit referuar dokumentit të paraqitur nga ky i fundit me qëllim përmbushjen e kritereve të veçanta të kualifikimit për proçedurën objekt shqyrtimi. Ne zbatim te nenit 82 pika 1 të ligjit 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i RSH, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Synimi i kërkesës së autoritetit kontraktor për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose autorizimit nga distributori zyrtar i autorizuar për mallrat objekt prokurimi është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar mallra origjinale, me garanci, pra autorizimi nga prodhuesi/distributori zyrtar është një dokument nëpërmjet të cilit autoriteti kontraktor sigurohet që subjekti/shoqëria që lëshon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij duke siguruar garancinë e mallit. Sa më lart, dokumentacioni i paraqitur nga ky operator ekonomik nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Prandaj kerkojme qe nga ana e anetareve te Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave dhe Komisioni i Prokurimit Publik kerkojme qe te verifikojne kete pretendim tonin, si dhe kerkojme skualifikimin e ketij operatori ekonomik.

Se fundimi referuar dokumentave te tenderit, procedura e prokurimit objekt ankimi eshte Procedurë e hapur. Referuar pikes 2 të neni 24 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave për prokurimin publik , i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: 2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. , në këto kushte, duke qënë se procedura e prokurimit objekt ankimi është procedurë nën kufirin e lartë monetar ligjvënësi ka përcaktuar se gjuha e prokurimit e përdorur është gjuha shqip dhe rrjedhimisht dhe oferta e dorezuar duhet ti permbahet gjuhes se prokurimit. Akoma më tej siç percaktohet ne rregullat e prokurimit publik vetem në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Ne rastin konkret në dokumentet e tenderit Njoftimi i kontratës , seksioni 4 Procedura , pika 4.7, i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon: 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: SHQIP X ANGLISHT ?, kur gjuha e prokurimit eshte perzgjedhur gjuha shqip operatori ekonomik ofertues duhet të përkthejë dhe noterizojë sipas legjislacionit në fuqi dokumentacionin shoqërues të ofertës. Në këto kushte sa më sipër arsyetuar, Kerkojme nga ana e KSHA dhe KPP-se qe te verifikohet nese dokumentat Autorizim Prodhuesi, Autorizim Distributori, dokumenti qe verteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit i dorëzuar nga OE Olsi Motors SHPK jane të përkthyer në gjuhën shqip në përputhje me parashikimet e rregullave të prokurimit publik.

Per sa i perket pretendimit se operatori ekonomik Olsi Motors nuk ploteson piken 2.3.2 kapaciteti teknik te kritereve te veçanta të kualifikimit të Shtojcës 8 Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit: të dokumentave të tenderit.

Ne lidhje me kriterin 2.3.2 te percaktuar ne shtojcen 8/2 kriteret e vecanta per kualifikim nga ana e AK eshte kerkuar se: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për artikujt 1-8 objekt prokurimi. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog apo cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike duhet të paraqiten në gjuhën shqipe ose të përkthyera dhe të noterizuar. Ne shtojcen 6 Formulari i Specifikimeve Teknike te dokumentave standarte te tenderit nga ana e autoritetit kontraktor jane percaktuar specifikimet teknike te produkteve me nr rendor nga 1-8. Pikerisht kriteri i percaktuar ne piken 2.3.2 te DST autoriteti kontraktor ka kerkuar qe per secilin artikull 1- Ndriçues LED 100W; 2- Ndriçues LED 50W; 3- Konektorë për kabull 2x16 mm2; 4- Tirantues për kabull 2x16 mm2; 5- Automat 4P 40 A; 6- Sensor muzgu 25 A; 7- Lëshues 4P 45 A; 8- Automat 2P 25 A., të paraqitet katalog/fragment katalogu/skede teknike, por me kusht qe se pari secili nga keto tre dokumente te paraqitura duhet te tregojne lehtesisht dhe qartesisht se cilit prodhues i perkasin pra me pak fjale nuk mund te pranohet si katalog apo skede teknike nje flete format A4 me specifikimet teknike te marra nga DST sic ndodhe rendomte me OE, dhe se dyti katalogu/fragmenti katalogu/skeda teknike duhet te permbaje cdo specifikim teknik te pershkruar ne shtojcen 7 te dst. Me qellim qe te vertetohet perputhshmeria e specifikimeve teknike. Nisur nga pjesemarrja e viteve te kaluara ne kete procedure ku nje pjese e operatoreve ekonomike jane skualifikuar pikerisht per mosplotesim te ketij kriteri pasi nuk kane paraqitur katalog ose fragment katalogesh/skede teknike per te gjith artikujt dhe kataloget/skedat teknike te paraqitura nuk permbanin te gjitha specifikimet teknike te percaktuara nga AK ne shtojcen 7 Formulari Specifikimeve Teknike. Duke njohur eksperiencen e operatorit ekonomik Olsi Motors SHPK ne kete fushe prokurimi kemi bindjen tone se:

Per artikullin nr.1- Ndricues LED 100W nuk ploteson specifikimin teknik oret e punes se kerkuara nga AK eshte 40.000 ore pune, produkti i paraqitur nga ky OE si moster nuk ka 40.000 ore pune por me pak. Gjithashtu per kete artikull AK ka percaktuar qe fluksi i ndricimit te jete 11700 lumen, produkti i praqitur si moster dhe katalogu per kete produkt fluksin e ndricimit e ka me pak sec eshte kerkuar ne DST. Faktori i fuqise nga AK eshte kerkuar > 0.9, ne katalogun e paraqitur nga ky operator ekonomik eshte me i ulet, nuk plotesohet si specifikim teknik. Gjithashtu nuk plotesohet edhe standarti teknike CE, ROHS, EN 60598-2-3:2003+A1:2011, EN IEC 60598-1:2021+A11:2022, EN IEC 55015:2019+A11:2020 ose ekuivalentet e tyre. Per artikullin nr. 2- Ndricues LED 50W ne shtojcen 7 Formulari i Specifikimeve Teknike eshte percaktuar se oret e punes per kete artikull duhet te jene 40.000 ore pune, produkti i paraqitur nga ky OE ne katalog nuk e permbush kete specifikim pasi eshte me me pak ore pune. Gjithashtu per kete artikull AK ka percaktuar qe fluksi i ndricimit te jete 5800 lumen, Fuqia e ndricuesit: 50W, Temperatura e ngjyres (K): 6000 - 6400K, Faktori i

fuqise >0.9 produkti i praqitur si moster dhe katalogu per kete produkt nuk i permbushin keto parametra te kerkuar nga AK ne DST. Gjiyhashtu nuk plotesohet dhe standarti teknik CE, ROHS, EN 60598-2-3:2003+A1:2011, EN IEC 60598-1:2021+A11:2022, EN IEC 55015:2019+A11:2020 ose ekuivalentet e tyre.

Per artikullin nr. 5- Automat 4P 40A ne shtojcen 7 Formulari i Specifikimeve Teknike eshte percaktuar se Temperatura e operimit duhet te jete -25 deri ne 70 C, produkti i paraqitur nga ky OE ne katalog nuk e permbush kete specifikim pasi temperatura operimit eshte me me pak sec eshte kerkuare. Gjithashtu per kete artikull AK ka percaktuar qe Shkalla e impaktit te goditjes - IK02, Rryma e vleresuar- 40A, Tensioni i izolimit të vlerësuar Ui - 500V, Tension i vlerësuar i rezistencës së impulsit Uimp- 4kV, Kapaciteti i vlerësuar i ndërprerjes së qarkut të shkurtër Icn sipas EN 60898 në 230 V- 10kA, produkti i praqitur si moster dhe katalogu per kete produkt nuk i permbushin keto parametra te kerkuar nga AK ne DST. Gjithashtu nuk plotesohet dhe standarti teknik CE, ROHS, EN 60598-2-3:2003+A1:2011, EN IEC 60598-1:2021+A11:2022, EN IEC 55015:2019+A11:2020 ose ekuivalentet e tyre.

Per artikullin nr. 7- Leshues 4P 45 Ane shtojcen 7 Formulari i Specifikimeve Teknike eshte percaktuar se Tensioni i bobinës-100...250 V AC/DC, produkti i paraqitur nga ky OE ne katalog nuk e permbush kete specifikim pasi tensioni bobines eshte me me pak sec eshte kerkuare. Gjithashtu per kete artikull AK ka percaktuar qe Tensioni maksimal i qarkut të fuqisë-690 V AC, Fuqia e motorit në AC-3 400 V- 22 kW, Klasa e mbrojtjes- IP20 (terminalet), IP10 në pjesët e tjera, Temperatura e punës – 60 C deri + 80 C, Pesha rreth 0.95 kg, produkti i praqitur si moster dhe katalogu per kete produkt nuk i permbushin keto parametra te kerkuar nga AK ne DST. Gjithashtu nuk plotesohet dhe standarti teknik EN60947-1:2007/A1:2011/A2:2014, EN IEC60947-4-1:2019, EN60947-5-1:2017, EN IEC 63000:2018 ose ekuivalentet e tyre. Në nenin 40 pika 6 germa b) Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund tu kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose??.. Cmojmë të theksojmë faktin se vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që ti shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kërkesat e veçanta për kualifikim, janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për tu përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti

kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. Në rastin Objekt akmimi nuk rezulton të jetë përmbushur ky detyrim nga ana e OE Olsi Motors SHPK, cka sjell si pasojë një ofertë që nuk është në përputhje me dokumentet e tenderit dhe kriteret e përcaktuara në to dokumente, arsye për të cilën duhet të refuzohet si te papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, duhet të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit tu kërkojë ofertuesve të paraqesin kataloget/skedat teknike. Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 Për prokurimin publik, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Per sa më sipër provohet se kulaifikimi i OE Olsi Motors SHPK është bërë në mënyrë të padrejtë dhe është një ofertë e pasukseshme pasi nuk garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktuara në DT. Për sa më sipër rezulton e provuar se Autoriteti Kontraktor ka kryer shkleje të dispozitave ligjore.

Nisur nga pervoja jone e gjate ne fushen e tregtimit e materialeve elektrike jemi te bindur se ky ofertues nuk ka plotesuar ashtu sikurse eshte kerkuar nga ana e autoritetit kontraktor ne piken 2.3.2, konkretisht kemi bindje se ky kataloget/skedat teknike te dorezuara prej tij nuk permbajne te gjitha specifikimet e kerkkuara nga AK ne shtojcen 7. Qellimi i ligjvenesit ne nenin 40 pika 6 e VKM 285 eshte qe mostra e mallit, kerkohet kur AK e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike, per te vetetuar permbushjen e specifikimeve teknike. Jo me kot kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 dhe 3 i ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garanci kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Te gjithe operatorët ekonomikë qe synojne te marrin pjese ne nje procedure janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Vetem mbi bazen e permbushjes se specifikimeve teknike garantohet permbushja e cilesise se kerkuar. Ne gjykimin tone ky operator ekonomik nuk ka përmbushur kërkesat minimale sic janë përputhja e të dhënave të

deklaruara për artikujt që do të ofertoj me të dhënat që përmban artikulli i paraqitur si mostër objekt skualifikimi duke mos plotësuar kriteret për kualifikim me mostrat e paraqitur në këtë procedurë prokurimi.

Bazuar ne ligjin e prokurimit publik, kerkojme nga KPP qe si institucion me i larte ne fushen e prokurimit public te marre parasysh kete informacion dhe te merren masat e nevojshme per verifikimin e mostrave, katalogeve/skedave teknike nese ato jane ne perputhje me permbajtjen e kriterit 2.3.2 dhe me specifikimet teknike te kerkuara nga AK. Qendrim ky tashme i mbajtur nga KPP ne vendimarrjen e saj si ne rastin e vendimit 370/2023; vendimit 1029/2025; dhe vendimit 1212/2025.

Persa thame me larte, kerkojme skualifikimin e ofertes se operatorit ekonomik Olsi Motors shpk, nga kjo procedure prokurimi per mos plotesim te kritereve kualifikuese si dhe specifikimeve teknike ne kete procedure prokurimi. Se fundimi referuar dokumentave te tenderit, procedura e prokurimit objekt ankimi ?sht? Procedurë e hapur . Referuar pikes 2 të neni 24 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave për prokurimin publik, i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: 2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht, në këto kushte, duke qënë se procedura e prokurimit objekt ankimi është procedurë nën kufirin e lartë monetar ligjvënësi ka përcaktuar se gjuha e prokurimit e përdorur është gjuha shqip dhe rrjedhimisht dhe oferta e dorezuar duhet ti permbahet gjuhes se prokurimit. Akoma më tej siç percaktohet ne rregullat e prokurimit publik vetem në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Ne rastin konkret në dokumentet e tenderit Njoftimi i kontratës , seksioni 4 Procedura , pika 4.7, i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon: 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: SHQIP X ANGLISHT, kur gjuha e prokurimit eshte perzgjedhur gjuha shqip operatori ekonomik ofertues duhet të përkthejë dhe noterizojë sipas legjislacionit në fuqi dokumentacionin shoqërues të ofertës. Në këto kushte sa më sipër arsyetuar, Kerkojme nga ana e KSHA dhe KPP-se qe te verifikohet nese dokumentat katalog/fragment katalogesh/skede teknike te dorëzuar nga OE Olsi Motors SHPK jane të përkthyer në gjuhën shqip në përputhje me parashikimet e rregullave të prokurimit publik. Gjithashtu i kerkojme komisionit te shqyrtimit te ankesave qe te shqyrtojne me pergjegjesi kete pretendim tonin, pasi kemi pershtypjen se procesi i vleresimit i bere nga kvo-ja eshte bere ne kundershtim me kriteret kualifikuese, pasi ka kualifikuar nje oprator ekonomik ne kundershtim me kriteret kualifikuese dhe ne mungese dokumetacioni dhe ne rast se nuk do te shqyrtohet me pergjegjesi ky pretendim atehere do ta kerkojme te drejten tone dhe prane organeve ligjzbatuese.

Per sa i perket pretendimit se operatori ekonomik Olsi Motors nuk ploteson piken 2.3.4 kapaciteti teknik te kritereve te veçanta të kualifikimit të Shtojcës 8 Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit: të dokumentave të tenderit.

Ne kriterin kualifikues te pikes 2.3.4 te siperpermendur eshte percaktuar kriteri kualifikues si ne vijim: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Deklaratë/Çertifikatë Konformiteti CE ose raportet e testimit të lëshuara nga ente çertifikues të akredituar, për artikujt 1-8 objekt prokurimi, për të cilat janë kërkuar standarte teknike të miratuara, sipas specifikimeve teknike të pasqyruara në dokumentet standarte te tenderit, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së standarteve teknike të kërkuara.

Ne lidhje me permbushjen e ketij kriteri akutoriteti kntraktor ne DST ka keruar qe operatoret ekonomik te paraqesin Deklaratë/Çertifikatë Konformiteti CE ose raportet e testimit të lëshuara nga ente çertifikues të akredituar. Ne kemi dyshimet tona se ky operator ekonomik nuk ka paraqitur as Deklarate/Certifikate konformiteti nga prodhuesit gjithashtu nuk kane paraqitur as rraport testime e kerkuar per artikujt nga 1-8 objekt prokurimi. Nderkohe qe ne permbushje te kriterit kualifikues dhe dispozitave ligjore te nenit 77 te LPP duhet paraqiste njerin nga keto dy dokumente, persa kohe qe i ka pranuar kushtet dhe kriteret e gares dhe nuk i ka ankimuar ato.

Persa parashtruam me siper, kerkojme qe te skualifikohet operatori ekonomik Olsi Motors shpk per mosplotesimin nga ana e tij te kriterit kualifikues te dhene ne piken 2.3.4 Kriteret e Vecanta te Kualifikimit te dokumentave te tenderit, pasi pervecese nuk ka paraqitur per produketet nga 1-8 deklaraten e konformitetit nuk ka paraqitur as raport testimit.

Se fundimi referuar dokumentave te tenderit, procedura e prokurimit objekt ankimi eshte Procedurë e hapur. Referuar pikes 2 të neni 24 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave për prokurimin publik, i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: 2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht, në këto kushte, duke qënë se procedura e prokurimit objekt ankimi është procedurë nën kufirin e lartë monetar ligjvënësi ka përcaktuar se gjuha e prokurimit e përdorur është gjuha shqip dhe rrjedhimisht dhe oferta e dorezuar duhet ti permbahet gjuhes se prokurimit. Akoma më tej siç percaktohet ne rregullat e prokurimit publik vetem në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Ne rastin konkret në dokumentet e tenderit Njoftimi i kontratës, seksioni 4 Procedura, pika 4.7, i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon: 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: SHQIP X ANGLISHT, kur gjuha e prokurimit eshte perzgjedhur gjuha shqip operatori ekonomik ofertues duhet të përkthejë dhe noterizojë sipas

legjislacionit në fuqi dokumentacionin shoqërues të ofertës. Në këto kushte sa më sipër arsyetuar, Kerkojme nga ana e KSHA dhe KPP-se qe te verifikohet nese dokumentat deklratat e konformitetit/rraport testimet te dorëzuar nga OE Olsi Motors SHPK jane të përkthyer në gjuhën shqip në përputhje me parashikimet e rregullave të prokurimit publik. Gjithashtu i kerkojme komisionit te shqyrtimit te ankesave qe te shqyrtojne me pergjegjesi kete pretendim tonin, pasi kemi pershtypjen se procesi i vleresimit i bere nga kvo-ja eshte bere ne kundershtim me kriteret kualifikuese, pasi ka kualifikuar nje oprator ekonomik ne kundershtim me kriteret kualifikuese dhe ne mungese dokumetacioni dhe ne rast se nuk do te shqyrtohet me pergjegjesi ky pretendim atehere do ta kerkojme te drejten tone dhe prane organeve ligjzbatuese.

Per sa i perket pretendimit se operatori ekonomik Olsi Motors shpk nuk ka plotesuar paragrafin 5 te pikes 6 te nenit 26 - Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, te VKM- se nr 285/2021, i ndryshuar, ne te cilin thuhet: Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat a , b , d , dh , e , h , i dhe j të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Operatori ekonomik Olsi Motors SHPK, ne momentin e kerkuar, ka paraqitur dokumenta te cilat nuk provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Dokumentat e paraqitura nga ana e ketij OE, si: 1- Vertetimin per pagesen e taksave dhe tatimeve, 2- Vertetimin per pagesen e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, 3- Vertetim per pagesen e energjise elektrike, 4- Deshmit e penalitetit per subjektin dhe administratorin/ortakun jane dokumenta te datave pas dates se ofertimit, pra ne kundershtim me kerkesen e mesiperme te VKM- se dhe DT. Lutemi anetareve te KSHA, per shqyrtimin e ankeses tone referohuni LPP, VKM se per RRPP, si dhe disa vendimeve te KPP -se, per raste te njejta: Nr. 209/2025, Datë 07.02.2025 dhe Nr. 333/2025, Datë 05.03.2025, Nr. 656/2025, Datë 14.05.2025, si dhe saktesisht vendimeve nr. 146/2026, date 27.01.2026 dhe nr. 594/2026, date 06.05.2026, ne te cilet, nder te tjera thuhet: KPP gjykon, se operatori ekonomik ..... duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor në sistemin elektronik të prokurimeve me datë lëshimi para hapjes së ofertave dhe si rrjedhim duhet të dorëzonte dokumetacionin e cituar më sipër në këtë vendim me datë lëshimi të dokumentave jo më vonë se me datë ..... Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë. Vlerësimi

i dokumentacionit, i cili do të sigurohej në të ardhmen nga operatorët ekonomikë, do të cenonte në thelb konceptin e prokurimit publik, i cili i nënshtrohet afateve të përcaktuara procedurale ligjore. KPP nuk mund të vlerësojë një fakt apo dokument të ri, i cili sigurohet pas datës së hapjes së ofertave, në respektim të parimit të barazisë, mosdiskriminimit, referuar nenit 3, pika 1 të ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik , i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.Përsa më sipër, Komisioni gjykon se dokumentacioni provuese i parashikuar në shkronjën b , të pikës 2, të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, i datës ..... i paraqitur nga operatori ekonomik ..... si provë e deklarimit të bërë në formularin përmbeldhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e kritereve të përgjithshme për kualfikim duke qenë se ka datë të mëvonshme nga data e hapjes së ofertave (.....) nuk provon gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore e rregullatore në fuqi për prokurimin publik dhe si rjedhim nuk do të konsiderohet i vlefshëm, ndërsa dokumentacioni provues i parashikuar në shkronjat a , d , dh , e , h , i dhe j , të pikës 2, të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar.

Rrjedhimisht, sa me lart argumentuam, KSHA- ja dhe KPP- ja, duhet te Skualifikoje oferten OE Olsi Motors SHPK.

- Kerkojme skualifikimin e ofertes se operatorit ekonomik Olsi Motors SHPK, si oferte qe nuk permbush kriteret kualifikuese.

II.7. Në datën 25.08.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit përfundimtar të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.8. Në datën 25.08.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e lidhjes së kontratës të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.9. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2648/2 prot, datë 26.08.2026 me kriteret të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK, të parashtruara në ankesën me nr. 2648/2026 prot, datë 25.08.2026.

II.10. Me shkresën nr. 1374/2 prot, datë 26.08.2026, me objekt "*Shkresë Përcjellëse*", protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2648/2 prot., datë 26.08.2026 (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike) autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Kamëz ka dërguar informacion, dhe vendimin e KSHA-së nr. 1374/1 prot, datë 26.08.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "*2 AS Invest*" SHPK, nga verifikimi i të cilit rezulton se pretendimet e ankimuesit janë refuzuar me arsyetimin se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjorë.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor u konstatua se, pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar formulari argumentave nr 2648/3 prot, datë 26.08.2026 nga subjekti i interesuar "Olsi Motors" SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

II.12. Me shkresën nr. 1374/2 prot, datë 26.08.2026, me objekt "*Shkresë Përcjellëse*", protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2648/4 prot., datë 31.08.2026 (ardhur nëpërmjetë shërbimit postar) autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Kamëz ka dërguar informacion, dhe vendimin e KSHA-së nr. 1374/1 prot, datë 26.08.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "*2 AS Invest*" SHPK, nga verifikimi i të cilit rezulton se pretendimet e ankimuesit janë refuzuar me arsyetimin se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjorë.

III
Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, (thema decidendum) në zbatim të Vendimit Nr. 74, datë 25.06.2025 të Gjykatës Administrative të Apelit, ***Pika III. Vlerësimi i Gjykatës,*** *31. Për kushtin tjetër formal të padisë, respektimin e afatit ligjor.....,: "... Praktika gjyqësore e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. (00-2017-927) 670, datë 30.05.2017, konfirmon të njëjtin qëndrim: "... Gjykata Administrative e Shkallës së Parë të Tiranës e ka zbatuar gabim ligjin për përllogaritjen e afatit të prerë të ankimit administrativ. Në këtë pjesë të çështjes, Kolegji konfirmon plotësisht bazueshmërinë në ligj të qëndrimit të Gjykatës Administrative të Apelit, se... edhe afatet e parashikuara nga neni 63 i Ligji për prokurimin publik duhet të interpretohet sikur rregullojnë të gjithë ligjet procedurale, sikur neni 62 i Kodit të Procedurave Administrative apo neni 148, 443 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile.* ***Sipas gjykatës së apelit, afati i ankimit administrativ, nis të llogaritet gjithmonë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit...****",* si dhe duke u mbështetur në nenin 97 pika 5 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar në të cilin përcaktohet se: *"5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatese."* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar siç është procedura e prokurimit objekt ankimi, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 7 ditë nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të kontratës, publikimit të ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit, publikimit të njoftim fituesit paraprak ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në pikën 5 të aktit rregullator të sipërcituar nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatese.

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*2 AS Invest*" SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik "Olsi Motors" SHPK me arsyen se nuk plotëson kriterin*: "2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. Ose b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 "*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*", pika 2.3.1 "*Kapaciteti teknik*", e të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është përcaktuar kriteri si më poshtë:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se* ***40%*** *e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:*

a) *Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.*

ose

b) *Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formular përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik "*Olsi Motors"* SHPK, ku në pikën B. Deklaratë Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet e të cilëve do të mbështetet

Operatori Ekonomik ka deklaruar si subjekt mbështetës operatorin ekonomik "Anadea" SHPK për procedurën konkrete të prokurimit, dhe kapaciteti mbi të cilin do të mbështetet operatori ekonomik ankimues është "Kapaciteti teknik": 2.3.1. Punë e ngjashme, dhe 2.3.5 Mjet transporti.

- Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit nga operatorit ekonomik "Anadea" SHPK;

- Deklaratë angazhimi si subjekt mbështetës;

- Kontratë Furnizimi me nr. 292/5 prot., datë 05.05.2026 me objekt "Blerje materiale elektrike", lidhur midis operatorit ekonomik "Anadea" SHPK dhe autoritetit kontraktor Agjencia e Shërbimeve Publike Bashkia Berat, me vlerë 5.774.000 lekë pa tvsh.

- Vërtetim Realizimi Nr. 464 prot, datë 21.07.2026 lëshuar nga Agjencia e Shërbimeve Publike Bashkia Berat për operatorin ekonomik "Anadea" SHPK, me anë të të cilit vërteton se operatori ekonomik "Anadea" SHPK ka përmbushur 100% Kontratën e Furnizimit nr. 292/5 prot., datë 05.05.2026.

- Faturë tatimore nr. 21/2026, datë 10.06.2026, me vlerë 120.000 lekë pa tvsh

III.1.3. Në nenin 2 "*Qëllimi i ligjit*" të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit public.*

III.1.4. Në nenin 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisorsocial e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.6. Në nenin 84 "*Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*" të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar parashikohet:
1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.
2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.
4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.
5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.
6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.
7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues".

III.1.7. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se*: "3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...".*

III.1.8. Në nenin 40 "*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*" pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", e ndryshuar, parashikohet se:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore37, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

III.9. Në nenin 90 "*Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi".

III.1.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.11. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik ka kërkuar që "*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se **40%** e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: **a)** Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të*

furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ***ose*** ***b)*** *Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara*.

Komisioni konstaton, se operatori ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit dhe referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se operatori ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si subjekt mbi të cilin do të mbështetet sa i takon pikës 2.3.1 (furnizime të ngjashme) të kapacitetit teknik, operatorin ekonomik "*Anadea*" SHPK shoqëruar me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe deklaratën e angazhimit të këtij të fundit, i cili angazhohet posaçërisht për të mbështetur operatorin ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK për Kapacitetin teknik, 2.3.1.Pune e ngjashme, dhe 2.3.5 Mjet transporti. Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, është përcaktuar qartë se: "*2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës*;" Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcakuar që: "*4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor*". Në rastin konkret, duke gjykuar se operatori ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në seksionin përkatës në pikën B, "*Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik*" si subjekt mbështetës operatorin ekonomik "*Anadea*" SHPK, lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë, KPP gjykon t'i drejtohet urdhërimeve të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar . Referuar parashikimeve më sipër duhet që operatori ekonomik "*Olsi Motors*", si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera, të plotësojë 50% të kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik, ndërkohë ankimuesi, rezulton të jetë mbështetur plotësisht te subjekti mbështetës "*Anadea*" SHPK, i deklaruar si subjekt mbështetës në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, çfarë bie ndesh edhe me parashikimet e dispozitës më sipër. Në nenin 84 "*Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*", të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik konkretisht parashikohet se: "*1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në*

dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij". Komisioni gjykon se duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo gjykohet e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale, si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik është përcaktuar që jo vetëm duhet të deklarohet në dokumentet e ofertës mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera, por janë përcaktuar edhe kriteret për këtë mbështetje, njëri prej të cilëve është që në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, dispozitë e cila në rastin konkret me dokumentacionin e paraqitur nuk plotësohet nga ankimuesi, pasi ai është mbështetur plotësisht te operatori ekonomik "*Anadea*" SHPK lidhur me Kapacitetin teknik pikën 2.3.1 të dokumentave të tenderit, punët e ngjashme, sikurse provohet nga deklarimi i bërë në formularin përmbledhës të vetdeklarimit dhe kontrata e ngarkuar në SPE. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Olsi Motors" SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor sa i takon kriterit 2.3.1 të dokumentave të tenderit dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "*2 AS Invest*" SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*2 AS Invest*" SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK me arsyen se nuk plotëson kriterin: *"2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/ distributori zyrtar për* ***artikujt 1-8*** *objekt të prokurimit. Në rast se do te paraqitet autorizim distributori duhet te provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Secili nga dokumentat duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: tel, fax, email, ëebsite, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8/2 "*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*", pika 2.3.3 "*Kapaciteti teknik*", e të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është përcaktuar kriteri si më poshtë:

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/ distributori zyrtar për* ***artikujt 1-8*** *objekt të prokurimit. Në rast se do te paraqitet autorizim distributori duhet te provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Secili nga dokumentat duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: tel, fax, email, ëebsite, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij.*

III.2.2. Në shtojcën 7 "*Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin sasinë dhe afatin e lëvrimit të artikujve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

NR	EMËRTIMI I MALLIT	NJËSIA	SASIA
1	Ndriçues LED 100W	copë	**2000**
2	Ndriçues LED 50W	copë	1020
3	Konektorë për kabull 2x16 mm2	copë	5868
4	Tirantues për kabull 2x16 mm2	copë	5868
5	Automat 4P 40 A	copë	15
6	Sensor muzgu 25 A	copë	100
7	Lëshues 4P 45 A	copë	15
8	Automat 2P 25 A	copë	15
9	Automat 1P 10 A	copë	15
10	Automat 1P 16 A	copë	15
11	Automat 1P 25 A	copë	15
12	Automat 4P 80 A	copë	10
13	Lëshues 3P 63 A	copë	10
14	Lëshues 3P 80 A	copë	5
15	Lëshues 4P 63 A	copë	15
16	Izolant elektrik (asia italia) *"ose ekuivalente"*	copë	150

III.2.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

[....] Dokumentin "*Autorizim Distributori*" datë 17.07.2026, lëshuar nga shoqëria "*Sali Elektrik*" SHPK për operatorin ekonomik "Olsi Motors" SHPK, ku citohet, si më poshtë vijon; "Ne, shoqërrija Sali Elektrik me administrator B. S, në cilësin e distributorit të produkteve që tregtojmë, autorizojmë operatorin ekonomik "Olsi Motors" SHPK të marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje materiale të ndryshme elektrike", të zhvilluar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz", me numër reference REF-92685-07-07-2026. Sali Elektrik SHPK është distributor i një marke të caktuar Legrand, Icel, Pedrollo, etj. Me këtë autorizim konfirmojmë se Autorizojmë operatorin ekonomik Olsi Motors SHPK të ofertojë dhe furnizojë produktet tona në këtë procedurë prokurimi. Produktet që do të furnizohen janë origjinale, të reja dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Në rast shpallje fitues do të

sigurojmë disponueshmërinë e produkteve dhe furnizimin e tyre sipas kërkesave të kontratës. [....].

III.2.4. Në nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.".

III.2.5. Ndërkohë në nenin 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.".

III.2.6. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4, "*Kërkesat për kualifikim*" të ligjit 162/2020, "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e

nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

III.2.7. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar përcaktohet se: "*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...".*

III.2.8. Në nenin 40 "*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*" pika 3 dhe 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "P*ër miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.".

III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacionin që vërteton që plotësojnë këto kërkesa. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve

teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.10. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3.3 ka kërkuar shprehimisht që "*2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/ distributori zyrtar për* ***artikujt 1-8*** *objekt të prokurimit. Në rast se do te paraqitet autorizim distributori duhet te provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Secili nga dokumentat duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: tel, fax, email, ëebsite, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij*". Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "*2 AS Invest*" SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK me arsyetimin se: "OE Olsi Motors, nuk plotëson kriterin sipas pikës 2.3.3 të Kapacitetit Teknik në lidhje me Autorizimin e prodhuesit / distributorin zyrtar", si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik "Olsi Motors" SHPK, ka ngarkuar në SPE: "[...] *Dokumentin "Autorizim Distributori" datë 17.07.2026, lëshuar nga shoqëria "Sali Elektrik" SHPK për operatorin ekonomik "Olsi Motors" SHPK, ku citohet, si më poshtë vijon; "Ne, shoqërrija Sali Elektrik me administrator B. S, në cilësin e distributorit të produkteve që tregtojmë, autorizojmë operatorin ekonomik "Olsi Motors" SHPK të marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje materiale të ndryshme elektrike", të zhvilluar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz", me numër reference REF-92685-07-07-2026. Sali Elektrik SHPK është distributor i një marke të caktuar Legrand, Icel, Pedrollo, etj. Me këtë autorizim konfirmojmë se Autorizojmë operatorin ekonomik Olsi Motors SHPK të ofertojë dhe furnizojë produktet tona në këtë procedurë prokurimi. Produktet që do të furnizohen janë origjinale, të reja dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Në rast shpallje fitues do të sigurojmë disponueshmërinë e produkteve dhe furnizimin e tyre sipas kërkesave të kontratës.* [....]". Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE Komisioni konstaton se operatori ekonomik ka paraqitur autorizimin e distributorit nga shoqëria Sali Elektrik i cili pohon në dokument që është distributor i Legrand, Icel, Pedrollo, por nuk ka paraqitur një autorizim të lëshuar nga këta prodhues për shoqërinë Sali Elektrik në mënyrë që të vërtetohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit sikurse është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2.3.3 të dokumentave standarte të tenderit, duke mos vërtetuar në këtë mënyrë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar. Në këto kushte Komisioni gjykon se operatori ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK me autorizimin e ngarkuar në SPE nuk e përmbush pikën 2.3.3 të kritereve të veçnta të kualifikimit, pasi nuk provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit.

Në këto kushte Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e dorëzuar nuk e përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit pikën 2.3.3 të dokumentave të tenderit. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori

ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik "Olsi Motors" SHPK, duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Sa më sipër, Komisioni gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar operatori ekonomik ankimues nuk e plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 të dokumentave të tenderit.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankmiues "*2 AS Invest*" SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "*2 AS Invest*" SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III.1 dhe III.2 gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

III.4. Së fundi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit pasi në datën 25.08.2026 ka publikuar në SPE Njoftim Fituesin Përfundimtar dhe Njoftimin e Lidhjes se Kontratës, si më poshtë vijon:

Emri	Numri	Autoriteti Kontrak Procedurat	Anulluar ne
Blerje materiale të ndryshme elektrike	REF-92685-07-07-2026	Ndërmarrja e Shë E hapur	

Objekti i Procedurës	Krijuar në	Statusi	Perfunduar ne	Krijuar nga	Lloji i Procedures
Kohezgjatja dhe vlera e parashikuar	07.07.2026 15:37	Përfunduar	07.07.2026 15:38	AdminOfficer	E hapur
Zyrtaret e Prokurimit	07.07.2026 15:38	Përfunduar	07.07.2026 15:39	AdminOfficer	E hapur
Kriteret e Pjesemarrjes	07.07.2026 15:39	Përfunduar	07.07.2026 15:51	AdminOfficer	E hapur
Kriteret e Vleresimit	07.07.2026 15:51	Përfunduar	07.07.2026 15:51	AdminOfficer	E hapur
Dokumentet e Tenderit	07.07.2026 15:51	Përfunduar	07.07.2026 15:54	AdminOfficer	E hapur
Informacioni Administrativ	07.07.2026 15:54	Përfunduar	07.07.2026 15:55	AdminOfficer	E hapur
Njoftimi i Kontrates	07.07.2026 15:55	Përfunduar	07.07.2026 15:57	AdminOfficer	E hapur
Publikimi i Njoftimit te Kontrates	07.07.2026 15:57	Përfunduar	08.07.2026 09:46	PublishingOfficer	E hapur
Dorezimi i Ofertave	08.07.2026 09:46	Përfunduar	23.07.2026 10:02	AdminOfficer	E hapur
Vleresimi i Ofertave	23.07.2026 10:02	Përfunduar	05.08.2026 15:15	AdminOfficer	E hapur
Kerkohet Ri-Vleresim?	05.08.2026 15:15	Përfunduar	13.08.2026 13:49	AdminOfficer	E hapur
Njoftimi i Fituesit Paraprak	13.08.2026 13:49	Përfunduar	13.08.2026 13:53	AdminOfficer	E hapur
Publikimi i Njoftimit te Fituesit Paraprak	13.08.2026 13:53	Përfunduar	14.08.2026 12:20	PublishingOfficer	E hapur
Njoftimi i Fituesit Paraprak	14.08.2026 12:20	Përfunduar	14.08.2026 13:22	AdminOfficer	E hapur
Publikimi i Njoftimit te Fituesit Paraprak	14.08.2026 13:22	Përfunduar	17.08.2026 12:11	PublishingOfficer	E hapur
Konfirmimi i fituesit	17.08.2026 12:11	Përfunduar	24.08.2026 13:44	AdminOfficer	E hapur
Njoftimi i Fituesit Perfundimtar	24.08.2026 13:44	Përfunduar	24.08.2026 13:48	AdminOfficer	E hapur
Publikimi i Njoftimit te Fituesit Perfundimtar	24.08.2026 13:48	Përfunduar	25.08.2026 13:22	PublishingOfficer	E hapur
Njoftimi i Lidhjes se Kontrates	25.08.2026 13:22	Përfunduar	25.08.2026 14:25	AdminOfficer	E hapur
Publikimi i Njoftimit te Lidhjes se Kontrates	25.08.2026 14:25	Përfunduar	26.08.2026 14:26	PublishingOfficer	E hapur
Konfirmim i lidhjes se kontrates	26.08.2026 14:26	U hap		AdminOfficer	E hapur

Përmes këtyre veprimeve të mësipërme, autoriteti kontraktor ka kryer shkelje proceduriale të cilat vijnë në kundërshtim me pikën 2, të nenit 112, "*Veprimet paraprake*" të ligjit 162/2020 *të Ligjit të Prokurimit publik, i ndryshuar* ku përcaktohet se: "*2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik"...*Si dhe nenit 100 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimin publik*" i ndryshuar përcaktohet se: *"1.Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.".*

Sa më sipër duke qenë se AK nuk ka zbatuar parashikimet ligjore të sipërcituara, konsiderohet se ka kryer shkelje procedurale të cilat vijnë dhe në kundërshtim me pikën 1, nenit 100 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimin publik*" i ndryshuar , si dhe pikën 2, të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020 Ligji Prokurimin publik, i ndryshuar.

Referuar nenit 119 "*Pavlefshmëria e kontratave*" të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik, i ndryshuar sipas të cilit parashikohet se: *1. Një kontratë do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme në rastet e mëposhtme: b) kur nuk janë zbatuar parashikimet e këtij ligji në lidhje me zbatimin e procedurave të ankimit, duke privuar personat e interesuar për të ushtruar të drejtën e tyre për ankim;d) Nëse një autoritet ose ent kontraktor ka nënshkruar një kontratë duke mos respektuar vendimin e dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Referuar nenit 118, "Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik" *të ligjit nr. 162/2020 Ligji Prokurimin publik, i ndryshuar* sipas të cilit parashikohet se:
3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:
a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se akti administrativ i KVO-së i datës 25.08.2026 në për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit, me publikimin e njoftim fituesit pwrfundimtar dhe me publikimin e njoftimit për lidhjen e kontratës, do të konsiderohen si akte absolutisht të pavlefshme.

Në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", parashikon se "*Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi*

tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj." Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet se "*Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi*". Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: *(i) veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët*; *(ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest).*

Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sisitemit juridik), gjykon se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facia të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", konstaton se akti administrativ publikimi i njoftim fituesit përfundimtar dhe akti administrativ publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës i datës 25.08.2026, të procedurës së prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor, janë akte administrative absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A.

Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA në të cilën parashikohet se "*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.*" autoriteti kontraktor duhet të marrë masat për kthimin e situatës juridike në fazën e vlerësimit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se hapat proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-prokurimi cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisiprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se "*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*". Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese *Inter Allia* në vendimin 15/2010 ka theksuar se "*parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore".*

Për sa më sipër Komisioni vlerëson se në kushtet ku autoriteti kontraktor ka vijuar më publikimin e njoftim fituesit përfundimtar dhe publikimin e njoftimit të lidhjes së kontratës datë 25.08.2026 në shkelje të procedurës së prokurimit KPP gjykon se, kontratat të cilat janë lidhur në kushte e shkeljes së parashikimeve ligjore nuk prodhojnë pasoja juridike ç'ka nënkupton se një kontratë është absolutisht e pavlefshme që në momentin e krijimit të saj, pavarësisht kushteve ose veprimeve që ndodhin më pas. Kjo do të thotë se kontrata nuk ka efekte juridike, as për palët që e kanë nënshkruar atë, pasi ka ardhur si një kontratë e lidhur në shkelje të ligjit procedural si dhe substancial dhe si e tillë nuk ka mundësi të krijojë detyrime apo të drejta për palët.

Gjithashtu, duke marrë shkas nga shkeljet e konstatuara në këtë vendim, në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik, nisjen e hetimit administrativ për të gjithë zyrtarët përgjegjës në lidhje me parregullsitë konstatuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik",* i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "*2 AS Invest*" SHPK në procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur*", me Nr. REF-92685-07-07-2026, me objekt: "*Blerje materiale të ndryshme elektrike*", me fond limit 12,226,208 (*dymbëdhjetë milion e dyqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e tetë*) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.07.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Kamëz.

2. Autoriteti kontraktor të korrigjojë shkeljet e konstatuar si dhe të skualifikojë operatorin ekonomik "*Olsi Motors*" SHPK, sipas konstatimeve të këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Deklarimin absolutisht të pavlefshëm të njoftimit të lidhjes së kontratës për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.
5. T'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në shqyrtimin administrativ nr. 2648/2026 prot, datë 25.08.2025.

6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "*2 AS Invest*" SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	**Anëtar**	**Anëtar**	**Anëtar**
Gjergj Mersini	**Donika Daci**	**Edvin Simo**	**Nertil Kanina**

Kryetar
Ismail Shehu